

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**Tatimet në Bashkimin Evropian**

**T5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI

Data 29/06/2019

## PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA</b>
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
C. Detyra	60	
TOTAL	100	

## Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë Nga 2 pikë secila

1. Personat fizikë rezident të shtetit të Gjermanisë taten për të ardhurat me burim:
  - a) Vetëm në Gjermani
  - b) Gjermani dhe në shtetet e tjera të BE
  - c) Në Gjermani dhe në çdo shtet tjetër jashtë Gjermanisë
  - d) Vetëm në Gjermani dhe në shtetet e Beneluksit
  
2. Tatimit në të Ardhurat e Korporatave në Spanjë i nënshtrohen:
  - a) Korporatat SA/SRL, Njësitet e përhershme, Partneritete dhe Fondet
  - b) Personat Juridik
  - c) Organizatat shtetërore qendrore dhe lokale
  - d) Personat Fizikë
  
3. Humbjet Kapitale në shtetin e Kroacisë mund të :
  - a) Thyhen me fitimet e vitit të kaluar
  - b) Barten ndaj fitimeve të 5 viteve të kaluara
  - c) Barten ndaj fitimeve të 5 viteve të ardhshme
  - d) Kreditohen ndaj tatimit në vitin e ardhshëm
  
4. Periudha tatimore për Tatimin në të Ardhura të korporatave në Luksemburg është:
  - a) Përgjithësisht Viti kalendarik
  - b) Viti financiar që fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor
  - c) Viti financiar që fillon me 1 qershor dhe përfundon me 31 maj
  - d) Periudha 12 mujore
  
5. Shpenzimet e zbritshme për qëllime të TAK në Spanjë mund të jenë:
  - a) Shpenzimet e ndodhura dhe të dokumentuara
  - b) Shpenzimet e arsyetuara në mënyrë të duhur të ndodhura për qëllim të marrjes dhe ruajtjes së të ardhurave
  - c) Shpenzimet e ndodhura por të pa dokumentuara
  - d) Shpenzimet e ndodhura dhe të paguara

6. Vendimet shpjeguese individuale aplikohen në:

- a) Kroaci
- b) Gjermani
- c) Shqipëri
- d) Itali

7. Akcizës në Kroaci i nënshtrohen:

- a) Alkooli i prodhuar apo importuar
- b) Pijet alkoolike
- c) Duhani
- d) Energjia elektrike

8. Lehtësimi nga tatimi i dyfishtë në shtetet e BE-së lejohet

- a) Lejohet vetëm për tatimet e brendshme
- b) Përgjithësisht është i lejueshëm
- c) Lejohet vetëm për tatimet e jashtme
- d) Nuk lejohet asnjëherë

9. Tatimit në të ardhura personale në Gjermani vlerësohet si:

- a) Bashkëshortët rezidentë dhe partneret civil që jetojnë së bashku vlerësohen bashkërisht, përveç nëse zgjedhin të vlerësohen ndarazi
- b) Të ardhurat e fëmijëve taten ndarazi.
- c) Partneritet trajtohen si persona të ndarë.
- d) Partneri individual vlerësohet për pjesën e tij të profitit në të ardhurat e tij të biznesit vetanak

10. Pragu për regjistrim në TVSH në Kroaci është:

- a) Nuk ka prag
- b) Deri në 300,000 Kuna
- c) Mbi 300,000 Kuna
- d) Mbi 5,000,000 Kuna

## Pjesa B. Pyetjet opcionale “E saktë/ E pasaktë” Nga 1 pikë secila

1. Vetëm TVSH e ngarkuar në blerjet apo importet e personit të tatueshëm që i ka përdorë për furnizime të tatueshme, mund të zbritet ndaj TVSH-së së llogaritur që Personi i Tatueshëm ia ka ngarkuar blerësve/konsumatorëve të tij.
  - a. E saktë
  - b. E pasaktë
  
2. Përgjithësisht, luftimi i shmangies që nënkupton ri-karakterizimin e një transaksioni aplikohet në shtetet e BE-së.
  - a. E saktë
  - b. E pasaktë
  
3. Kusht themelor për zhvlerësimin e asetëve në shtetet e BE-së është Kostoja Historike e asetit dhe futja në përdorim e tij:
  - a. E saktë
  - b. E pasaktë
  
4. Persona të tatueshëm për qëllime të TVSH në Francë janë të gjitha bizneset, personat që kryejnë furnizime të tatueshme të mallrave dhe shërbimeve, përveq atyre që nuk kalojnë pragun për regjistrim.
  - a. E saktë
  - b. E pasaktë
  
5. Tjetër normë e TVSH-së aplikohet në Spanjë dhe në ishujt Belarikë dhe tjetër normë e TVSH-së aplikohet në Ishujt Kanarie.
  - a. E saktë
  - b. E pasaktë
  
6. Personat e vetëpunësuar që kryejnë aktivitete në territoret e kujdesit të veçantë shtetëror në Kroaci të cilët i përkasin kategorisë I, nuk janë të liruar nga tatimi.
  - a. E saktë
  - b. E pasaktë

7. Fitimet kapitale në Gjermani të ndodhura gjatë aktivitetit të biznesit trajtohen si të ardhura të biznesit
- E saktë
  - E pasaktë
8. Përgjithësisht rezervat dhe provizionet e ndryshme lejohen si shpenzime të zbritshme në të gjitha shtetet e BE-së por me kufizime të caktuara
- E saktë
  - E pasaktë
9. Në Holandë, deri në 75% të kostos së blerjes dhe zhvillimit të pasurisë mund të zhvlerësohet në vitin e parë, kurse për 25% të vlerës së pa zhvlerësuar duhet të ndiqen rregullat normale të zhvlerësimit
- E saktë
  - E pasaktë
10. Në asnjë nga Shtetet e BE-së nuk aplikohet norma progresive e Tatimit në Fitim.
- E saktë
  - E pasaktë
11. Në të gjitha Shtetet e BE-së përfshirë Shqipërinë, aplikohet norma progresive e Tatimit në të Ardhura Personale
- E saktë
  - E pasaktë
12. Transferimi i çmimit në Shtetet e BE-së përfshirë Shqipërinë, aplikohet vetëm për transaksionet në mes të palëve të lidhura.
- E saktë
  - E pasaktë

13. TVSH-ja vendoset në të gjitha nivelet e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve që ndodhin në Itali dhe në blerjet nga shtetet e tjera anëtare të BE-së. TVSH-ja gjithashtu vendoset për importimin e mallrave nga jashtë Bashkimit Evropian
- E saktë
  - E pasaktë
14. Në Slloveni një humbje e shkaktuar në njëren kategori të të ardhurave individuale, kompensohet kundrejt të ardhurave individuale pozitive të kategorisë tjetër.
- E saktë
  - E pasaktë
15. Tatimi në Trashëgimi dhe Dhurata aplikohet në të gjitha Shtetet e BE-së përfshirë edhe Shqipërinë.
- E saktë
  - E pasaktë
16. Baza për llogaritjen e detyrimeve doganore në Belgjikë është vlera doganore, e cila në përgjithësi është shuma e çmimit të paguar për mallrat dhe çdo shpenzim lidhur me sigurimin dhe transportin.
- E saktë
  - E pasaktë
17. Në Bashkimin Evropian, ligji doganor është i harmonizuar dhe zbatohet vetëm për lëvizjet e mallrave ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të treta.
- E saktë
  - E pasaktë
18. Zhvlerësimi dhe amortizimi i pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ishte i detyrueshëm në të gjitha shtetet e BE-së përfshirë edhe Shqipërinë pavarësisht nëse deklarata e tatimit në korporatat të kompanisë për atë vit rezultonte të ishte në pozitë humbëse
- E saktë
  - E pasaktë
19. Burimi i të ardhurës për persona individual dhe juridik përcaktohet në bazën e parimit ku krijohet/fitohet e ardhura e jo ku paguhet ajo e ardhur.
- E saktë
  - E pasaktë

20. Edhe në rastet kur e ardhura nga njësia e përhershme e vendosur në një shtet tjetër nuk duhet të njihen si e ardhur e tatueshme në shtetin ku ama është rezidente, kreditimi i tatimit të paguar nga njësia e përhershme e vendosur në shtetin tjetër duhet të njihet në shtetin ku ama është rezidentë.
- E saktë
  - E pasaktë

### **Pjesa C. Detyra - piket totale 60**

Kompania tregtare nga Sllovenia "XYZ" e cila merret me shitjet me pakicë dhe me shumicë të produkteve të amvisërisë dhe teknikës së bardhë. Në fund të vitit 2017 aksionari kryesorë i kësaj kompanie i cili zotëronte 55% të aksioneve ia kishte shitur aksionet e tij një aksionari që ishte rezident i një shteti tjetër të BE-së i cili menjëherë pas blerjes e ka ndryshuar aktivitetin e kompanisë nga ndërtime në tregtare. Gjatë vitit 2018 kishte këto transaksione:

#### **1. Bruto të Ardhurat:**

- Nga blerësit me shumicë në vlerën prej 25,600,350.00 Euro mbi të cilat ka ngarkuar TVSH-në
- Nga shitjet me pakicë nëpër marketet e ndryshme nëpër qytetet e ndryshme të Sllovenisë 12,505,406.00 euro mbi të cilat ka ngarkuar TVSH-në e llogaritur
- Nga shitja e një Aseti në vlerën bruto prej 5,305.00 euro
- Nga Inkasimi i borxheve të këqija të njohura në vitin 2017 e më përpara në vlerë prej 203,905.00 euro mbi të cilat do të llogaritet TVSH

#### **2. Shpenzimet:**

- Blerjet e mallrave tregtarë në vlerën prej 10,455,754.00 euro mbi të cilat i është ngarkuar TVSH
- Importet e mallrave tregtarë nga shtete jashtë Bashkimit Evropian 23,700,900.00 euro në të cilën vlerë është e përfshirë çdo ngarkesë tjetër doganore por jo TVSH.
- Stoqet në fillim të vitit 2018 ishin 4,305,058.00 euro
- Stoqet në fund të vitit 2018 ishin 5,650,509.00 euro
- Shpenzimet e qerasë ishin 45,000 euro prej të cilave 30% e tyre kanë qenë nga persona të tatueshëm kurse 70% e tyre nga persona jo të tatueshëm.
- Zhvlerësimi sipas pasqyrave në përputhje me standardet ishte 29,000.00 euro por që për 1,300.00 euro ishte më i ulët se sa zhvlerësimi sipas rregullave të legjislacionit tatimorë e në të cilin zhvlerësim nuk është përfshirë zhvlerësimi i aseteve të blera gjatë viti 2018 e të cilat janë futur në punë që në fillim të vitit.
- Amortizimi për emrin e mirë tregtarë dhe patentat ishte 10,000.00 euro
- Të punësuar kishte 120 punëtorë bruto pagat totale vjetore ishin 2,720,000.00 euro prej të cilëve, Drejtori kishte bruto pagën mujore prej 8,500 euro, 5 shefa të sektorëve të ndryshëm kishin bruto pagat mujore prej 4,800.00 euro, dhe 10 menaxher kishin bruto pagën mujore prej 3,300.00 euro. Të punësuarit e tjerë kishin pagën e njëjtë



- i. Shpenzimet e tjera operative ishin, 325,901.00 euro prej të cilave 75% e tyre ishin blerje nga personat e tatueshëm për TVSH kurse 25% e tyre ishin blerje nga persona jo të tatueshëm për TVSH
- j. Borxhet e këqija të lejueshme edhe për TAK edhe për TVSH në vlerën prej 322,340.00 euro mbi të cilat do të llogaritet TVSH e cila do të njihet si e zbritshme.
- k. Blerje të aseteve në vlerë prej 458,000.00 euro mbi të cilat i është llogaritur TVSH e për të cilat nuk është aplikuar për lejim investiv. Në vlerën totale janë të përfshirë edhe 10 asete në vlerë totale prej 4,500 euro e që secila prej tyre nuk e kalonte vlerën prej 500 euro
- l. Vlera neto e asetit të shitur ishte 3,550.00 euro
- m. Tatimi në fitim i paguar në vitin 2017 ishte 0.00 euro, kurse humbja në vitin 2017 ishte 2,001,098.00 euro
- n. Shpenzimet e argëtimit dhe të bordeve mbikëqyrëse ishin 250,000 euro
- o. Është marrë pëlqim nga Autoriteti Tatimorë për provizione në vlerë prej 28,000.00 euro

### 3. Të llogariten:

- a. Tvsh e llogaritur
- b. Tvsh e zbritshme
- c. Tvsh për pagesë
- d. Tatimi e mbajtur në burim në paga për të punësuarit për normat mujore:
- e. Kontributet
- f. Bruto të Ardhurat
- g. KMSH
- h. Bruto Shpenzimet e lejueshme pa përfshirë KMSH-në
- i. Shpenzimet e palejueshme
- j. Të Ardhurat e Tatueshme
- k. Fitimet Kapitale
- l. Tatimin në Fitim

#### Info shtesë:

Norma standard e TVSH-së 22%

Norma e Tatimit në fitim 19%

Norma e Fitimeve Kapitale 19%

Normat e tatimit në të ardhura vjetore personale (paga) :

Të ardhurat e tatueshme (euro)	Tatimi në shumën më të ulët (EUR)	Norma e tepricës (%)
Deri në 8,021.34	0	16
8,021.34 – 20,400	1,283.41	27
20,400 – 48,000	4,625.65	34
48,000 – 70,907.20	14,009.65	39
Mbi 70,907.20	22,943.46	50

Normat e kontributeve që i nënshtrohet punëdhënësi:

Kontributi për	Norma (%)
Sigurimi pensional	8.85
Sigurimi shëndetësor	6.56
Sigurimi i papunësisë	0.06
Pushimi i lehonisë	0.10
Sigurimi për lëndim	0.53
<b>Totali</b>	<b>16.10</b>

Normat e kontributeve që i nënshtrohet i punësuari:

Kontributet për	Norma (%)
Sigurimi i pensionit	15.50
Sigurimi shëndetësor	6.36
Sigurimi i papunësisë	0.14
Pushimi i lehonisë	0.10
<b>Totali</b>	<b>22.10</b>

## Zgjidhja e detyrës

<b>Pjesa C. Detyra 60 pike totale, nga 5 pike secila</b>	
<b>Nr.Pyetjes</b>	<b>Pergjigja e sakte</b>
a)	8,429,292.52
b)	7,744,862.35
c)	684,430.18
d)	488,738.69
e)	1,039,040.00
f)	38,314,966.00
g)	32,820,203.00
h)	4,042,511.00
i)	2,136,098.00
j)	1,452,252.00
k)	1,755.00
l)	275,927.88

		Tvsh e llogaritur	Total TVSH e llogaritur
Shitjet e tatueshme me shumice	25,600,350.00	5,632,077.00	
Shitjet me pakice	12,505,406.00	2,751,189.32	
Shitja e asetit	5,305.00	1,167.10	
Inkasimi I borxheve te keqija	203,905.00	44,859.10	8,429,292.52

		Tvsh e Zbritshme	Total TVSH e Zbritshme
Blerjet me TVSH te zbritshme	10,455,754.00	2,300,265.88	
Importet e mallrave	23,709,900.00	5,216,178.00	
Stoqet ne fillim	4,305,058.00		
Stoqet ne fund	5,650,509.00		
Shpenzimet e qerase	45,000.00	2,970.00	
Shpenzimi I zhvleresimit - IFRS	29,000.00		
Shpenzimi I zhvleresimit +	30,300.00		
Amortizimi I emrit te mire dhe patentave	10,000.00		
Shpenzimet e pagave	2,720,000.00		
Shpenzimet Operative	325,901.00	53,773.67	
Shpenzimet per argetim dhe te bordeve	250,000.00		
Borxhet e kqija	322,340.00	70,914.80	
Blerje Aseteve	458,000.00	100,760.00	
Vlera neto e asetit te shitur	3,550.00		
Tatimi ne fitim I paguar per vitin 2017	-		
Provizionet e aprovuara	28,000.00		
Humbja e vitit te kaluar (2017)	2,001,098.00		
			7,744,862.35

TVSH per pagese	684,430.18	
Bruto te ardhurat	38,314,966.00	Ka pas ndryshim pronesie mbi 50% dhe nuk lejohen te barten si shpenzim
KMSH	32,820,203.00	
Shpenzimet e lejueshme pa perfshire KMSH	4,042,511.00	Eshte perfshire edhe kontributi i punedhenesit
Shpenzimet e palejueshme	2,136,098.00	
Te Ardhurat e Tatueshme	1,452,252.00	
Fitimi kapital	1,755.00	Eshte i njohur si fitim biznesor sepse fitimet kapitale konsiderohen si te ardhura biznesore
Tatimi ne fitim	275,927.88	

**Llogaritjet e pagave**

Per nje (1) person ne baza mujore		Per totalin e te punesuarve ne baza mujore	Per totalin e te punesuarve ne baza vjetore
1 Pagat e drejtorit	8,500.00	8,500.00	102,000.00
Kontributi I Drejtorit	1,878.50	1,878.50	22,542.00
Kontributi I kompanise	1,368.50	1,368.50	16,422.00
Paga e tatueshme	6,621.50	6,621.50	79,458.00
Tatimi ne paga	2,268.25	2,268.25	27,218.94
5 Shefat nga	4,800.00	24,000.00	288,000.00
Kontributi per nje shef	1,060.80	5,304.00	63,648.00
Kontributi I kompanise	772.80	3,864.00	46,368.00
Paga e tatueshme	3,739.20	18,696.00	224,352.00
Tatimi ne paga	1,078.80	5,393.99	64,727.88
10 Menaxherat nga	3,300.00	33,000.00	396,000.00
Kontributi per nje manaxher	729.30	7,293.00	87,516.00
Kontributi i kompanise	531.30	5,313.00	63,756.00
Paga e tatueshme	2,570.70	25,707.00	308,484.00
Tatimi ne paga	681.51	6,815.08	81,780.96
104 Punetoret	1,934,000.00		
Paga mujore per nje punetore	1,549.68	161,166.67	1,934,000.00
Kontributi I punetorit	342.48	35,617.83	427,414.00
Kontributi I kompanise	249.50	25,947.83	311,374.00
Paga e tatueshme	1,207.20	125,548.83	1,506,586.00
Tatimi ne paga	252.41	26,250.91	315,010.91
<b>Total Tatimi ne paga</b>	<b>4,280.96</b>	<b>40,728.22</b>	<b>488,738.69</b>
<b>Total kontributi I punetorit</b>	<b>4,011.08</b>	<b>50,093.33</b>	<b>601,120.00</b>
<b>Total kontributi I kompanise</b>	<b>2,922.10</b>	<b>36,493.33</b>	<b>437,920.00</b>